

Abstrakti

Qëllimi i kësaj teme të diplomës është që të trajtohet dhe studiohet roli i Presidentit në garantimin e funksionimit kushtetues në Republikën e Kosovës. Rasti i Kosovës cilësohet si rast sui generis për shkak të rrethanave dhe mënyrës se si është krijuar si shtet në vete.

Sovraniteti buron nga qytetarët dhe u takon atyre, realizimin e bëjnë përmes përfaqësuesve të zgjedhur.

Presidenti ka një rol kyç dhe shumë të rëndësishëm në pozitën institucionale në Republikën e Kosovës.

Kapitulli V i Kushtetutës së Republikës së Kosovës paraqet statusin e Presidentit, kompetencat, kualifikimin për zgjedhjen, zgjedhja e Presidentit, mandati dhe betimi, papajtueshmëria, imuniteti, mungesa e përkohshme dhe shkarkimi i Presidentit.

Institucionet e Republikës kalojnë nëpër faza të ndryshme zhvillimi duke synuar që gjithmonë të jenë në pajtueshmëri me kushtetutën dhe ligjet aktuale duke pasur komunikim të vazhdueshëm mes institucioneve shtetërore.